

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7038
E premte, 3 nëntor 2023
Çmimi 0.50 €

Kaos dhe tym në
sallën e Kuvendit
të Shqipërisë | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RAMA PARALAJMËRON VIZITË NË PRISHTINË: DRAFT-STATUTI QË PRANUAN KOSOVA DHE SERBIA ËSHTË I BE-SË, KRENAR ME KONTRIBUTIN E SHQIPËRISË

FAQE 4-5



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se ndihet krenar për kontributin që ka dhënë Shqipëria në procesin e normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai

ka thënë se draft-statuti i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, që Kosova dhe Serbia kanë pranuar si dokument, është draft i BE-së. Rama ka treguar se mbështetjen

e tij do ta shprehë personalisht në një vizitë në Prishtinë, teksa ka theksuar edhe njëherë se Shqipëria mbështet fuqishëm Kosovën në zbatimin e marrëveshjes bazë

AKTUALE



BIDENI BËN THIRRJE PËR
"PAUZË" HUMANITARE
NË LUFTËN IZRAEL - HAMAS | FAQE 2

KAOS DHE TYM NË SALLËN E
KUVENDIT TË SHQIPËRISË | FAQE 2

PDK-JA: DHOMAT E SPECIALIZUARA
TË KOSOVËS TA NDALIN
PËRNDJEKJEN POLITIKE | FAQE 7

EKONOMI



INVESTIMET DIREKTE NË KOSOVË
DERI NË MUAJIN GUSHT ARRIJNË
514 MILIONË EURO | FAQE 8

RIZVANOLLI U PARAQET ODAVE
TË BIZNESEVE NË PARIS PAKON
INVESTIVE TË KOSOVËS PËR
ENERGJI 2023-25 | FAQE 8

SPORT



LLAPI NDALET NGA FUSHË-KOSOVA,
LIRIA BARAZOI ME DUKAGJININ | FAQE 10

UNDP-ja: MBI
90 PËR QIND E
QYTETARËVE TË
SHQETËSUAR
NGA RRRITJA E
ÇMIMEVE | FAQE 3



KOSOVA E PËRKUSHTUAR T'I PËRMBUSHË
TË GJITHA STANDARDET E KËSHILLIT TË
EVROPËS PËR ANËTARËSIM | FAQE 6



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni bën thirrje për “pauzë” humanitare në luftën Izrael - Hamas

WASHINGTON, 2 NËNTOR - Presidenti amerikan Joe Biden tha se duhet të ketë një “pauzë” humanitare në luftën Izrael - Hamas, pasi fjalimi i tij gjatë një tubimi zgjedhor u ndërpre të mërkurën mbrëma nga një protestuese që bëri thirrje për armëpushim. “Mendoj se na duhet një pauzë”, tha Bideni. Kjo deklaratë paraqet ndryshim në qëndrim, pasi Bideni dhe ndihmësit e tij, gjatë gjithë krizës në Lindjen e Mesme, kanë qenë të palëkundur në deklaratimet e tyre se nuk do të diktojnë se si izraelitët do t’i kryejnë operacionet e tyre ushtarake në përgjigje të sulmit të 7 tetorit të militantëve palestinezë të Hamasit. Por, presidenti amerikan është përballur me presion në rritje nga grupet për të drejtat e njeriut, nga liderët botërorë, por edhe nga anëtarët më liberalë të partisë së tij, të cilët kanë thënë se bombardimet e Izraelit në Gazë janë ndëshkim kolektiv dhe se

është koha për armëpushim. Në deklaratimin e tij, Bideni i bëri presion kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu që t’u ofrojë palestinezëve të paktën një pushim të shkurtër nga operacioni i vazhdueshëm ushtarak që ka lënë mijëra të vdekur dhe e ka zhytur Rripin e Gazës në një katastrofë humanitare. Shtëpia e Bardhë ka refuzuar të bëjë thirrje për armëpushim, por ka sinjalizuar se izraelitët duhet ta shqyrtojnë mundësinë e një pauze humanitare për t’u lejuar civilët që të marrin ndihmë dhe që shtetasit e huaj në Gazë të largohen nga ky territor. Trupat tokësore izraelite kanë përparuar afër qytetit të Gazës përdërisa janë përfshirë në luftime të ashpra me militantët, tha ushtria një ditë më parë. Ndërkaq, qindra shtetas të huaj dhe dhjetëra palestinezë të plagosur rëndë u lejuan që të largohen nga Gaza për në Egjipt pas më shumë se tre javësh nën



rrethim. Zëdhënësi i Këshillit për Siguri Kombëtare i Shtëpisë së Bardhë, John Kirby, tha të mërkurën se ambasadori i sapoemëruar amerikan në Izrael, Jack Lew,

shumë shpejt do të shkojë në Lindjen e Mesme për t’i “mbështetur përpjekjet e ShBA-së për të krijuar kushte për pauzë humanitare me qëllim që të adresohen kushtet e

përkeqësuar humanitare me të cilat po përballen civilët palestinezë”. Të mërkurën mbrëma Bideni ishte duke folur në një tubim në Mineapolis, kur një grua bërtiti: “Zoti President, nëse ta ndien për popullin hebre, unë po ju kërkoj që të bëni thirrje për armëpushim”. Pjesëmarrja e presidentit në këtë tubim zgjedhor shtyu mbi 1 000 persona që të organizonin një protestë në këtë qytet të cilët bënë thirrje për armëpushim në Gazë. Bideni tha se i kupton emocionet që kanë nxitur qytetarët të protestojnë. Ai tha se pauza “nënkupton që të jepet kohë që të burgosurit të dalin jashtë”. Më pas, Shtëpia e Bardhë sqaroi se Bideni e kishte fjalën për pengjet dhe ndihmën humanitare. Që nga 7 tetori në Izrael janë vrarë mbi 1 400 persona, shumica civilë, nga sulmet e Hamasit, ndërkaq nga sulmet hakmarrëse izraelite në Gazë janë vrarë mbi 8 500 persona.

Kaos dhe tym në sallën e Kuvendit të Shqipërisë

TIRANË, 2 NËNTOR - Në Shqipëri seanca e së enjtes e Kuvendit u mbizotërua nga kaosi dhe përplasjet në mes të opozitës dhe shumicës. Deputetët demokratë të cilët kishin hyrë më herët në sallë, mbledhën të gjitha karriget duke i grumbulluar ato përpara foltores së Kuvendit, një veprim i cili u shoqërua me konflikte direkte mes tyre dhe kolegëve socialistë. Ky qëndrim i opozitës ishte paralajmëruar, ndërsa drejtuesit demokratë ishin shprehur haptazi se “nuk do të ketë zhvillim normal të punimeve të parlamentit, për sa kohë nuk do të respektohen të drejtat e opozitës”. Deputetët demokratë akuzuan socialistët se po u refuzohet e drejta e tyre kushtetuese për ngritjen e komisioneve hetimore, apo se dhe përcaktan përfaqësuesit e opozitës në



Komisionin e Reformës Zgjedhore. Pavarësisht prej përpjekjeve të opozitës për t’i bllokuar punimet, socialistët zgjodhën të qëndrojnë në këmbë, ndërkohë

që kryetarja e parlamentit vazhdoi seancën me procedura të përsheptuara për miratimin e çështjeve në rend të ditës. Nga foltorja e Kuvendit deputeti

demokrat Ervin Salianji ndezi njëherë pas tjetrës disa tymuese. Punonjësit e gardës u përpoqën disa herë për t’ia marrë ato nga dora duke i nxjerrë jashtë sallës.

Përballë tij, në krahun e majtë, socialistët ngrinin kartonët për miratimin e akteve dhe ligjeve të ndryshme, pa asnjë debat, apo diskutim. E gjithë seanca zgjati pak më shumë se 25 minuta. Ish-kryeministri Sali Berisha tha pas mbylljes së seancës se ajo që ndodhi sot ishte një “reagim me forma të mosbindjes civile dhe një protestë nga deputetët e opozitës me kërkesën e prerë të rikthimit të të drejtave të tyre kushtetuese. Jemi opozita e të drejtave të mohuara, si kurrë ndonjëherë që 32 vjet”. Por deputeti socialist Erjon Braçe hodhi poshtë pretendimet se deputetëve opozitarëve po u shkelen të drejtat, por gjithçka që po ndodh, sipas tij, ka të bëjë me raportet e ish-kryeministrit Berisha me drejtësinë.

Vuçiqi: Është gënjeshtër se unë do ta nënshkruaj njohjen e Kosovës

Beograd, 2 nëntor - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i ka hedhur poshtë si “gënjeshtër” pretendimet se ai është i gatshëm ta nënshkruajë pavarësinë e Kosovës. “Nuk do ta nënshkruaj kurrë pavarësinë e Kosovës, ndërsa i përgëzoj të gjithë ata në skenën politike të Serbisë që thonë gënjeshtër të tilla”, tha Vuçiqi

në një video-mesazh në profilin e vet në “Instagram” të enjten. Ai nguli këmbë se “gjithmonë do t’i përmbahet Kushtetutës” së Serbisë. Partitë e krahut të djathtë në Serbi e kundërshtojnë Marrëveshjen e Ohrit të arritur në mes të Serbisë dhe Kosovës në fillim të këtij viti. Ata, gjithashtu, kanë kërkuar vazhdimisht ndërprerjen e

negociatave për normalizimin e marrëdhënieve që Serbia dhe Kosova po zhvillojnë nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian (BE) që nga viti 2011. Marrëveshja e Ohrit u arrit në mars në Maqedoninë e Veriut nga presidenti serb Vuçiq dhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, me ndërmjetësimin e BE-së.



Radhë para qendrës për regjistrimin e makinave në veri

MITROVICË, 2 NËNTOR - Një kolonë me automjete me targa "KM" u pa mëngjesin e 2 nëntorit para Qendrës për Regjistrim në Mitrovicë të Veriut, pasi Qeveria e Kosovës më 30 tetor vendosi për shtyrjen e afatit për reregjistrimin e automjeteve me targa ilegale serbe në ato RKS - Republika e Kosovës.

Shtyrjes së afatit i parapriu një kërkesë nga Drejtoria e Policisë e Kosovës për rajonin e veriut drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës. Kjo kërkesë u bazua në kërkesat e qytetarëve që kërkuan që ky afat të vazhdohej.

Sipas vendimit të qeverisë, afati për reregjistrimin e makinave me targa serbe sikurse "PR", "KM", "PZ" e të ngjashme do të jetë deri më 1 dhjetor.

Sinisha nga Mitrovica e Veriut, që po priste në radhë para Qendrës për Regjistrim nga ora 7:30, i tha "Radios Evropa e Lirë" se është lehtësuar nga vendimi i Qeverisë së Kosovës dhe se njerëzit kishin mbetur pa një zgjidhje tjetër, pos reregjistrimit në RKS, pasi ata nuk mund të lëvizin lirshëm në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Çfarë të bëj. Ju mund të largoheni nga

Kosova, por nuk mund të hyni sërish".

I pyetur pse nuk e kishte reregjistruar makinën e tij deri më tani në targa RKS, ai tha se besonte se do të mund të vazhdonte të lëvizte ende me makinën e tij me targa "KM".

"Të gjithë ndihemi të mashtruar", tha Sinisha.

Çështja e targave ka shkaktuar një sërë krizash në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe.

Fillimisht, më 31 korrik të vitit 2022 u ngritën barrkada për shkak të çështjes së targave dhe në nëntor të po atij viti serbët u larguan nga institucionet e Kosovës në veri, pasi u suspendua drejtori i policisë për rajonin e veriut, Nenad Gjuriq. Gjuriqi kishte refuzuar ta zbatonte vendimin e Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa serbe në RKS. Plani i Qeverisë së Kosovës i tetorit të vitit të kaluar parashihte që nga 21 prilli i vitit 2023 të lejohej vetëm qarkullimi i makinave me targa RKS.

Më 23 nëntor 2022, në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, Kosova dhe Serbia



arritën një marrëveshje për targat që lëshohen nga autoritetet serbe për qytetet në Kosovë.

Sipas marrëveshjes, Serbia pranoi që të mos lëshonte më targa të reja dhe Kosova hoqi dorë nga ndëshkimet që parashihte plani për reregjistrimin e makinave. Megjithatë, të dyja palët më vonë e interpretuan ndryshe këtë marrëveshje.

Më 6 dhjetor 2022 Qeveria e

Serbisë miratoi një dekret në bazë të të cilit automjetet me targa "KM" lejohen të lëvizin pa etiketë regjistrimi, gjegjësisht atyre u duhet t'u tregojnë zyrtarëve vetëm një policë kontrolli teknik.

Prishtina zyrtare e interpretoi këtë hap të Beogradit si rinovim të regjistrimit me arsyetimin se bie ndesh me marrëveshjen e Brukselit. Prandaj, autoritetet e Kosovës ndaluan qarkullimin e

makinave me targa "KM" në veri që ishin regjistruar në sistemin serb pas arritjes së marrëveshjes për targat në nëntorin e vitit 2022.

Mirëpo, zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Vetion Elshani, konfirmoi për "Radios Evropa e Lirë" se Policia e Kosovës pas skadimit të afatit për reregjistrim nuk ka shqyrtuar gjopa për qytetarët për shkak se kjo çështje ishte "çështje politike".

KMDLNj, politikanëve: Mos manipuloni me shifra të rreme, përmbushni kërkesat

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Më 1 nëntor pjesëtarë të Njesisë Speciale Intervenuese të Policisë së Kosovës dhe të Njesisë për Trajtimin e Mjeteve Eksplozive protestuan të mërkurën para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar rishikimin e kategorizimit për rrezikshmërinë në punë.

Një nga pjesëtarët e këtyre dy njësiveve lexoi dhe përsëriti kërkesat e tyre: kategorizimi si njësi të veçanta dhe përfshirjen në listën e ekspertëve, rrezikshmëria të caktohet në 50 për qind të pagës bazë dhe shtesa për kushte specifike të punës.

KMDLNj ka theksuar se edhe më parë ka reaguar duke kërkuar nga institucionet përgjegjëse t'i



përmbushin këto kërkesa në mënyrë që ta ruajnë dhe forcojnë

edhe më shumë profesionalizmin e Policisë së

Kosovës që është një ndër shtyllat kryesore për ruajtjen e

sigurisë dhe funksionimin e shtetit.

KMDLNj ka theksuar se nuk duhet të manipulohet me shifra të rreme. "Në të gjitha rastet kur Kosovës po i cenohet integriteti territorial, që të gjithë po shprehemi krenarë me policinë tonë, prandaj ka ardhur koha që këtë 'krenarinë' ta përkthejmë në përkrahje reale për Policinë e Kosovës dhe të mos mbetet retorikë politike për manipulim. Me këtë protestë krejtësisht të drejtë, policët protestues nuk kërkojnë asgjë më shumë se realizimin e të drejtave të tyre ligjore dhe njerëzore që iu takojnë me ligjet në fuqi dhe dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut", ka theksuar KMDLNj.

Policia, aksion policor në disa komuna

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Policia e Kosovës, konkretisht Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar, në kuadër të Drejtorisë për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda të PK-së, bashkë me njësitet mbështetëse policore, ka bërë realizimin e një urdhërkontrolli, bazuar në hetimet që ishin zhvilluar më herët në lidhje me dyshimet për veprën penale nga Neni

364 i KPRK-së "Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paaautorizuar e armëve apo materieve plasëse".


Gjatë këtij operacioni policor të enjten është bërë kontrollimi i shtëpive me objektet përcjellëse dhe një lokal në njëmbëdhjetë lokacione, në katër rajone: Prishtinë, Pejë, Mitrovicë dhe

Gjilan.

Gjatë kontrollit të këtyre lokacioneve janë gjetur dhe janë sekuestruar dëshmitë materiale: dy pushkë automatike AK 47, dy pushkë gjuetie, një pistoletë, pesë karikatorë, njëqind e gjashtëmbëdhjetë fishekë të kalibrave të ndryshëm etj.

Në polici janë shoqëruar dhjetë persona dhe, pas intervistimit të tyre, janë liruar në procedurë të rregullt.





Rama paralajmëron vizitë në Prishtinë: Draft-statuti që pranuan Kosova dhe Serbia është i BE-së, krenar me kontributin e Shqipërisë

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se ndihet krenar për kontributin që ka dhënë Shqipëria në procesin e normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka thënë se draft-statuti i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, që Kosova dhe Serbia kanë pranuar si dokument, është draft i BE-së. Rama ka treguar se mbështetjen e tij do ta shprehë personalisht në një vizitë në Prishtinë, teksa ka theksuar edhe njëherë se Shqipëria mbështet fuqishëm Kosovën në zbatimin e marrëveshjes bazë

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka përshëndetur draft-statutin e Bashkimit Evropian për Asociacionin. Ai ka shprehur krenari për kontributin e Shqipërisë. Në rrjetin social "X", Rama ka theksuar se drafti i pranuar nga Kosova dhe Serbia për normalizimin e marrëdhënieve është i BE-së. Ai shton se mbështetjen e tij do ta shprehë personalisht në një vizitë në Prishtinë, teksa thekson edhe njëherë se Shqipëria mbështet fuqishëm Kosovën në zbatimin e

marrëveshjes. "Nuk mund të jem dot më krenar se kaq për kontributin e fortë dhe konkret të Shqipërisë në vazhdimësinë e procesit të vështirë të normalizimit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë. Megjithatë, projektstatuti i AKShM-së, që Kosova dhe Serbia kanë pranuar si dokument të përshtatshëm pune, është draft i BE-së. Shqipëria mbështet fuqimisht Kosovën për zbatimin e Marrëveshjes Bazë dhe do të vazhdojë të luajë rolin e saj për të nxitur paqen, stabilitetin dhe bashkëpunimin rajonal midis të gjitha vendeve të rajonit tonë. Së shpejti, do të jem në Prishtinë për të treguar personalisht

mbështetjen time", ka shkruar Rama.

Draft statuti i propozuar së fundi nga diplomatët evropianë e ka një "pikë referimi" dhe kjo është pikërisht drafti i propozuar në qershor të këtij viti nga kryeministri shqiptar Edi Rama. Asokohe kryeministri Rama njoftoi se i kishte përcjellë presidentit Macron dhe kancelarit Scholz një draft për Asociacionin e Komunave Serbe, për të cilin kishte vënë në dijeni dhe presidentin e KE-së, Charles Mishel dhe palën amerikane. Burime diplomatike në BE deklaruan se Drafti i Ramës për Asociacionin ishte një "tekst serioz" për Bashkimin Evropian. Siç

deklaronte Rama, drafti i propozuar prej tij ishte punuar nga ekspertët e lartë amerikanë dhe evropianë prej kohësh në rast se dy palët, Kosovë - Serbi, nuk do merreshin vesh me njëra-tjetrën.

Kryeministri Albin Kurti ka shprehur gatishmëri ta nënshkruajë më 27 tetor në Bruksel Marrëveshjen Bazë për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, si dhe draftin e ofruar nga diplomatët perëndimorë për themelimin e Asociacionit, por një gjë të tillë e ka refuzuar presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula Von der Leyen, gjatë vizitës së saj në Prishtinë, u bëri thirrje autoriteteve të Kosovës t'i nisnin procedurat për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe bazuar në draft-propozimin e ofruar nga vendet e Perëndimit. Von der Leyen i bëri thirrje edhe Serbisë ta njohë "de facto" Kosovën. Pas një takimi që zhvilloi në Prishtinë me presidenten e

Kosovës, Vjosa Osmani, presidentja e Komisionit Evropian, tha se draft-statuti i propozuar së fundi nga diplomatët evropianë është në qendër të bisedimeve për heqjen e masave ndëshkuese ndaj Kosovës që BE-ja i ka vendosur më herët. "Është absolutisht e rëndësishme që të dyja palët të angazhohen, të bashkëpunojnë dhe bashkërisht diskutuam temën që Kosova mund ta nisë procedurën për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Serbia duhet ta bëjë njohjen de facto, të cilën do ta diskutojë nesër në Serbi dhe sigurisht dialogu i Bashkimit Evropian është vendi për t'i diskutuar këto tema", ka pohuar Von der Leyen. Me kërkesë të partive opozitare, kryeministri Albin Kurti më 3 nëntor do të raportojë para Kuvendit të Kosovës për dialogun me Serbinë, veçmas për draft-statutin e propozuar për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

IKShPK-ja: Ka rënie të vlerave të manganit në liqenin e Badocit, por jo për konsum

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar të enjten se është duke vazhduar përcjellja në vazhdimësi e cilësisë së ujit në liqenin akumulues të Badocit, i destinuar për pije dhe se nuk ka vend për panik. Sipas IKShPK-së, analizat e fundit laboratorike tregojnë ende vlera më të larta se niveli maksimal i lejuar i manganit në ujin e liqenit dhe në rrjetin

shpërndarës, sipas standardeve të parapara në Udhëzimin Administrativ nr. 10/2021 - Cilësia e Ujit për konsum nga njeriu. "Ekipet e IKShPK-së janë në terren 24/7 dhe po bëhen çdo ditë analiza fiziko-kimike të ujit të prodhuar në Fabrikën që furnizohet nga Liqeni akumulues i Badocit dhe qytetarët do të njoftohen me kohë për normalizimin e parametrave referent të ujit të

pijsëm. IKShPK apelon qytetarët të cilët furnizohen nga fabrika e ujit në liqenin e Badocit se uji mund të përdoret për pastrim, mirëmbajtje të higjienës dhe ambienteve të banimit si dhe për nevoja të tjera, uji në rajonet që furnizohen nga liqenjtë akumulues Batllava dhe Ujmani mund të përdoren për pije pa përkufizim. Shpëlarja e rezervuarëve të ujit në shtëpi dhe ndërtesat e

banimit të përbashkët me qëllim pastrimi të Manganit të shtresuar (përgjegjësi e amvisërive dhe këshillave të banimit)", ka njoftuar IKShPK-ja, duke theksuar se bashkëpunimi i IKShPK/QU dhe KRU-ve me institucionet shtetërore është në kontinuitet deri në qetësimin e situatës. "Po vazhdon bashkëpunimi i IKShPK-së me KRU 'Prishtina' deri në normalizimin e vlerave të manganit. I bëhet thirrje



popullatës që lidhur me këtë çështje t'i referohet vetëm njoftimeve zyrtare të këtyre dy institucioneve", ka njoftuar IKShPK-ja.

Sulmuesit e gazetarëve në veri s'u përballën me drejtësinë



PRISHTINË, 2 NËNTOR - Asnjë rast i sulmeve ndaj gazetarëve në veri të Kosovës, që ndodhën në muajin maj dhe qershor të këtij viti, nuk është duke u gjykuar. Sipas Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK), 30 sulme të tilla u regjistruan në atë zonë të banuar me shumicë serbe nga organet e Kosovës. “Ne e dimë se disa prej sulmuesve me maska që i kanë sulmuar gazetarët në veri janë identifikuar, janë arrestuar, por më vonë janë liruar nga organet e Kosovës. Ne kërkojmë drejtësi pavarësisht situatës së komplikuar politike në veri të vendit”, thotë kryetari i AGK-së, Xhemajl Rexha, për “Radion Evropa e Lirë”.

“Për gazetarët është e rëndësishme që drejtësia të vihet në vend, që sulmet ndaj tyre të mos mbesin të pandëshkuara”, thotë ai më 2 nëntor, në Ditën Ndërkombëtare për t'i dhënë fund mosndëshkimit të krimeve kundër gazetarëve. Dhjetëra gazetarë u sulmuan në veri të Kosovës derisa mbulonin protestat e grupeve të serbëve kundër kryetarëve të zgjedhur shqiptarë të komunave me shumicë serbe në atë zonë. Protestuesit i sulmuan fizikisht dhe verbalisht ata, i shtynë dhe i detyruan t'i fshinin pamjet. Automjetet e ekipeve të medieve u vandalizuan, po ashtu. Sulmet u dënuan ashpër nga institucionet

vendase dhe ndërkombëtare, të cilat bënë thirrje që “mediet të jenë në gjendje të punojnë pa dhunë dhe pa frikësim”. Ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, raportoi në qershor për arrestimin e së paku tre sulmuesve të dyshuar të gazetarëve në veri, por nuk është e qartë se si janë proceduar rastet e tyre.

Reagime po, por jo edhe të dënuar

Venera Xhoxhaj-Adili ishte në mesin e atyre që u sulmuan. Gazetarja e “Radio Televizionit të Kosovës” po raportonte nga komuna e Leposaviqit më 16 qershor kur u sulmua fizikisht. “Unë kam dhënë atë ditë një deklaratë në Stacionin e Policisë në Leposaviq. Edhe një telefonatë pas disa ditësh e kam marrë nga zyrtarë policorë, për të siguruar se jam deklaruar. Nuk kam informacione zyrtare se çka ka ndodhur, pasi edhe nuk e kam proceduar tutje rastin”, thotë Xhoxhaj-Adili për “Radion Evropa e Lirë”.

Ajo shton se reagimet ndaj sulmeve ishin të shumta, por se ato nuk u përballën me ndonjë të dënuar për kryerjen e tyre. Më 30 maj, një taksist me të cilën po udhëtonte një ekip i “Radios Evropa e Lirë”, u sulmua, po ashtu, në Zubin Potok. Sulmi ndodhi derisa makina ishte në lëvizje dhe

asnjeri nga pjesëtarët e ekipit të “REL”-it nuk pësoi lëndime.

Nga sistemi i drejtësisë i Kosovës thonë se i trajtojnë me prioritet të gjitha rastet e dhunës dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. “Me planin strategjik për qasje në drejtësi, gazetarët gëzojnë mbrojtje të veçantë”, thotë për “Radion Evropa e Lirë” Afrim Shala, kryetar i Komisionit për Analizimin e Planeve Strategjike për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025 dhe për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimet të organizuar 2022-2024. “Nuk mund të them se rastet e tilla [të gazetarëve] nuk janë trajtuar. Ne kemi disa raste nga praktika jonë gjyqësore që kanë përfunduar dhe të dënuarit i kanë marrë dënimet e merituar kur gazetarët kanë qenë viktimë”, thotë Shala, por pa i përmendur rastet e sulmeve ndaj gazetarëve në veri.

“REL”-i e pa Planin Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025, në të cilin përmendet “trajtimi me prioritet të lartë i rasteve penale, ku viktimat janë personat e ndjeshëm, përkatësisht gazetarët”.

Për këtë qëllim thuhet se Komisioni për Analizimin e Planeve Strategjike “e ka parë të arsyeshme dhe të nevojshme që t'i propozojë Këshillit Gjyqësor të Kosovës që ta shqyrtojë mundësinë e caktimit të një gjyqtari si koordinator për rastet penale, ku viktimat janë

gazetarët”. Deri ku ka arritur kjo procedurë, nuk është e qartë.

“REL”-i kontaktoi pa sukses prokurorinë në Prishtinë. Policia e Kosovës, ndërkaq, tha në një deklaratë me shkrim se sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve janë sulme ndaj lirisë së fjalës dhe se, për këtë arsye, ajo vazhdimisht “ka ndërmarrë dhe vazhdon të marrë masa ligjore ndaj kryesve të kësaj natyre”. Në deklaratë nuk specifikohet asgjë në lidhje me sulmet ndaj gazetarëve në veri.

“Sulmuesit e gazetarëve e kanë vendin në burg”

Juristja e medieve në Kosovë, Flutura Kusari, thotë se mosndëshkimi i kriminelëve që sulmojnë gazetarët, nxit kriminelët e tjerë të veprojnë njëjtë. “Sulmuesit e gazetarëve e kanë vendin në burg. Policia, prokuroria dhe gjykatat duhet t'i trajtojnë krimet ndaj gazetarëve me profesionalizëm dhe guxim të njëjtë siç i trajtojnë sulmet dhe kërcënimet që iu bëhen politikanëve të fuqishëm”, thotë Kusari për “Radion Evropa e Lirë”. Rexha i AGK-së këmbëngul, po ashtu, se policia dhe sistemi i drejtësisë i Kosovës duhet të punojnë më shumë dhe t'i ndëshkojnë përgjegjësit e sulmeve ndaj gazetarëve. “Ajo çka ka ndodhur në vitin 2023 paraqet rritje alarmuese të sulmeve dhe

krimeve kundër gazetarëve - me theks të veçantë mbi ato që kanë ndodhur brenda pesë javëve, në fund të muajit maj dhe në qershor, në veriun e Kosovës”, thotë Rexha.

Për krahasim, AGK-ja në vitin 2022 regjistroi 33 raste, ku gazetarët ishin viktimat të dhunës fizike, të sulmeve apo kërcënimeve. Në vitin 2021 u regjistruan 29 raste të tilla.

Për ta shënuar Ditën Ndërkombëtare për t'i dhënë fund mosndëshkimit të krimeve kundër gazetarëve, AGK-ja organizoi një fushatë online me mesazhe dhe thirrje për rëndësinë e ndëshkimit të kërcënimeve dhe sulmeve kundër gazetarëve. “Unë edhe sot nuk e kam një përgjigje për fëmijët e mi: Pse për shkak të punës sime, deshën t'i djegin së gjalli edhe ata”, ishte mesazhi i gazetarit të RTK-së, Alban Selimi, i cili hapi fushatën.

Selimit, në mars të këtij viti, i ishte djegur garazhi i shtëpisë.

Për ambasadorin amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, i cili iu bashkua fushatës së AGK-së, “një medie e lirë është thelbësore për një demokraci të shëndoshë”.

Organizata për të Drejtat e Njeriut “Human Rights Watch”, në raportin e publikuar këtë vit për të drejtat e njeriut në botë, përmendi “reagimin e dobët të organeve të shtetit” ndaj “çështjes së keqtrajtimit të gazetarëve në Kosovë”.

Kosova, e përkushtuar që t'i përmbushë të gjitha standardet e Këshillit të Evropës për anëtarësim

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim Dora Bakoyannis, raportuese për Komisionin e Çështjeve Politike të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE) për aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës.

Anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, presidentja Osmani e ka cilësuar jo vetëm prioritet i Republikës së Kosovës, por edhe domosdoshmëri për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mirëqenies së të gjithë qytetarëve pa dallim. Në këtë kontekst, presidentja Osmani ka shprehur mirënjohje për vizitën e raportueses Bakoyannis për përgatitjen e opinionit, i cili do ta shqyrtojë kërkesën e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës, duke shfaqur besimin për një proces të drejtë dhe të bazuar në merita.

Sipas Osmanit, Kosova ka inkorporuar Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe

dokumente të tjera ndërkombëtare në Kushtetutën e saj, duke siguruar të drejtat e të gjithë qytetarëve, përfshirë komunitetet joshumicë, sundimin e ligjit dhe qeverisjen demokratike, siç është dëshmuar edhe nga vlerësimi i disa organizatave ndërkombëtare. "Kosova është e përkushtuar t'i përmbushë të gjitha standardet e Këshillit të Evropës për anëtarësim. Kushtetuta e Kosovës veçse ka përfshirë konventat kyçe të Këshillit të Evropës duke i bërë ato të zbatueshme në Kosovë. Në këtë frymë, Kosova është e përkushtuar fuqimisht ndaj vlerave evropiane, duke përfshirë demokracinë, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit", ka theksuar presidentja Osmani.

Osmani në takim me raportuesen Bakoyannis ka nënvizuar se Kosova pret që debati dhe votimi i opinionit për aplikimin e Kosovës të bëhet sa më parë në mënyrë që të procedohet edhe me votimin formal për anëtarësimin e saj



nga Komiteti i Ministrave. "Vitin e ardhshëm Këshilli i Evropës do ta shënojë 75-vjetorin e themelimit të tij. Kështu, do të ishte shumë simbolike që vetë Këshilli i Evropës, si organizata kryesore e të drejtave të njeriut në kontinentin tonë, ta hapte

derën për një vend demokratik, që aspiron t'i bashkohet familjes së vlerave", ka thënë presidentja Osmani. Në këtë takim Osmani e ka njoftuar raportuesen Bakoyannis edhe lidhur me sfidat aktuale me të cilat po përballet Republika e Kosovës si

dhe për aktin e agresionit të kryer nga ana e Serbisë me datën 24 shtator.

Edhe kryeministrit Albin Kurti e ka pritur në takim raportuesen për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, Dora Bakoyannis.

UNDP-ja: Mbi 90 për qind e qytetarëve të shqetësuar nga rritja e çmimeve

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ka lansuar analizën e pulsit publik të titulluar "Shqyrtimi i dinamikës së varfërisë së amvisërive përballë inflacionit" me një prezantim të gjetjeve kryesore dhe një tryezë të rrumbullakët me aktorë të ndryshëm.

Analiza, e cila synon ta vlerësojë shkallën në të cilën inflacioni ka ndikuar në mirëqenien ekonomike të njerëzve në Kosovë, është bërë përmes anketimit të 1 500 ekonomive familjare dhe hulumtimit të plotë studimor. Gjetjet tregojnë se shpenzimet për nevojat bazë, duke përfshirë gjërat ushqimore, transportin, shërbimet komunale, shëndetësinë, qiranë dhe shpenzimet e arsimit, janë rritur gjatë tre viteve radhazi.

Disa nga gjetjet kryesore tregojnë se në vitin 2021, 38.8 për qind e ekonomive familjare shpenzuan 200 ose më shumë



euro për gjëra ushqimore dhe kjo vlerë u rrit në 47.8 për qind dhe deri në 59.5 për qind të ekonomive familjare në vitet 2022, respektivisht 2023.

Duke i përdorur të dhënat e të hyrave dhe kufirin e varfërisë prej 1.85 eurosh për person në ditë, shkalla e varfërisë në vitin 2023 vlerësohet të jetë 16 për

qind. 10 për qind e ekonomive familjare ishin dukshëm më të varfra në mes të viteve 2023 dhe 2021, duke treguar një rënie në

krahasim me vitin e kaluar.

Krahasuar me vitin 2021, në vitin 2023, një shtesë prej 10-përqindësh e familjeve të anketuara jetonin nën pragun prej 1.85 eurosh në ditë, kur merren parasysh të dhënat për rritjen e çmimeve.

Inflacioni ka ndikuar në mirëqenien mendore dhe sociale, duke shkaktuar ndërprerje në aktivitetet rutinore dhe rritje të stresit, duke çuar në cilësi më të ulët të jetës. 46 për qind e respondentëve deklaruan se stresi dhe ankthi i tyre janë rritur si rezultat i rritjes së çmimeve. 91.4 për qind e të anketuarve shprehën shqetësime për ndikimin e mundshëm negativ të rritjes së çmimeve në gjendjen financiare të familjes së tyre. 69.2 për qind e të anketuarve raportuan se duhej t'i përshtatnin zakonet e tyre të shpenzimeve ose buxhetin në përgjigje ndaj çmimeve më të larta vitin e kaluar.

Vendoset gurthemeli i Qendrës Rinore dhe Kulturore në Rahovec

RAHOVEC, 2 NËNTOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka marrë pjesë në vendosjen e gurthemelit të Qendrës Rinore dhe Kulturore në këtë komunë. Sipas kryetarit Latifi, ky objekt modern do ta gjallërojë jetën kulturore dhe aktivitetet e rinisë në komunën e Rahovecit.

Objekti ka një sipërfaqe totale prej 6,203.24 m², salla universale/auditorium, me

rreth 400 ulëse, zhveshtore dhe salla për prova etj. "Shkolla e Muzikës me sipërfaqe prej 780.0 m² për shumë qëllime, studio për kërcim, klasa amë, klasa për balet, salla për instrumente dhe administratë; Qendra për Inovacion dhe Teknologji me sipërfaqe prej 415.0 m², me përmbytje, si: laborator, punëtori, sallë për takime dhe trajnime, zyrë të hapura dhe të ndara; Biblioteka me sipërfaqe

prej 420.0 m², ku përfshihen sallat për lexim grupor dhe individual, skedarët, ekspozimi i librit, fototeka, sallë për kompjuterë; Galeri të arteve; Kafetari me kuzhinë dhe tarracë të jashtme; Administrata e objektit 145.0 m²; Parking nëntokësor dhe të jashtëm, gjithsej 54 vende. Vlera e kontratës është: 2,982,584.55 euro", ka njoftuar komuna e Rahovecit.



QKUK: 172 gra u operuan nga kanceri i gjirit

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Është rritur numri i operacioneve të karcinomës së gjirit, në kuadër të Klinikës së Kirurgjisë Torakale, të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Bazuar

në statistikat e kësaj klinike, vetëm këtë vit, deri më tani, janë kryer 172 operacione të karcinomës së gjirit, kurse tërë vitin 2022 ishin kryer 149 raste. Pacientet që kanë nevojë për operacion pas

karcinomës së gjirit nuk kanë nevojë të shkojnë për trajtim jashtë vendit, ngaqë klinika ka numër të mjaftueshëm dhe profesional të mjekëve dhe stafit që kryejnë të gjitha llojet e operacioneve të gjirit.

Për operacion, pas karcinomës së gjirit, nuk ka listë të pritjes dhe të gjitha gratë që kanë nevojë për operacion trajtohen me prioritet nga mjekët e klinikës.



Në Prishtinë u mbajt Samiti i Ballkanit Perëndimor kundër Diskriminimit Racor

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me presidenten e vendit, Vjosa Osmani-Sadriu, hapën zyrtarisht punimet e Samitit të Ballkanit Perëndimor kundër Diskriminimit Racor.

Ky samit dyditësh shënon një ngjarje të rëndësishme vjetore që bashkon palët kryesore të interesit nga i gjithë rajoni, për t'i ndarë më së miri praktikën dhe strategjitë për adresimin dhe luftimin e diskriminimit racor ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Këtë vit, me moton "Unitet në diversitet", samiti nuk do të fokusohet vetëm në sfidat, por edhe në histori suksesi e praktika të mira, qofshin ato të institucioneve apo komuniteteve. Përveç bashkimit të ekspertëve, liderëve dhe aktivistëve për të diskutuar dhe zhvilluar strategji efektive për luftimin e diskriminimit racor në të gjitha format e tij, samiti ofron



platformë për ndarjen e historive dhe përvojave të njerëzve të prekur nga diskriminimi racor. Në fjalët e tij të hapjes, kryeministri Kurti ka theksuar se shtetet përfitojnë nga diversiteti etnik, dhe se "sot jemi këtu me

përkushtimin për të mos lejuar që diskriminimi të rrezikojë një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët tanë pa dallim". Duke veçuar secilën arritje që ka kontribuar në luftimin e pabarazisë dhe diskriminimit,

kryeministri tha se ne jemi këtu sot dhe do të flasim nesër e çdo ditë për rrugën tonë të përbashkët. Ndërkaq presidentja Osmani ka deklaruar se ndihet e nderuar të jetë në hapjen e Samitit të

Ballkanit Perëndimor kundër Diskriminimit Racor të cilin e konsideroi një platformë të duhur për ta ngritur zërin tonë kundër diskriminimit të çfarëdo lloji, në të njëjtën kohë edhe për ta rforcuar përkushtimin tonë institucional kundër diskriminimit racor në veçanti.

Pjesë e ceremonisë së hapjes ishte edhe një ekspozitë pikturash me autorë nga komunitetet rom, ashkali e egjiptianë, si dhe të fëmijëve të Qendrës Ditore për Fëmijë në Situatë rruge.

Në këtë samit janë mbajtur sesione të ndryshme si: Buxheti i përgjegjshëm për romët; Praktikë e mira dhe sfidat në dy nivelet e qeverisjes; Mekanizmat institucionalë për zbatimin e ligjeve dhe politikave kundër diskriminimit racor; Njohuritë digjitale; Ekzaminimi i pengesave ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian; Histori suksesi dhe praktikë më të mira në luftën kundër diskriminimit racor - Përvoja nga Ballkani Perëndimor; si dhe Shërbimet e bazuara në komunitet.

PDK-ja: Dhomat e Specializuara të Kosovës ta ndalin përndjekjen politike

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) shpreh shqetësimin e madh ndaj fushatës së bastisjeve që po zhvillojnë Dhomat e Specializuara të Kosovës ndaj ish-zyrtarëve të shtetit dhe anëtarëve të saj. Për PDK-në, këto bastisje janë tërësisht të panevojshme, tendencioze dhe shkojnë në nivelin e përndjekjes politike. "Kosova ka themeluar Dhomat e Specializuara për të ofruar drejtësi me standarde evropiane dhe jo spektakël në emër të saj. Mbi të gjitha, kjo fushatë përndjekëse shpërfaqë dështimin e Dhomave të Specializuara për të argumentuar aktakuzat e tyre në proceset gjyqësore", është thënë në reagimin e PDK-së. Sipas kësaj partie, Dhomat e Specializuara të Kosovës janë

themeluar me vendim të Kuvendit të Kosovës, me mandat të qartë dhe të kufizuar për t'i hetuar krimet e pretenduara për trafikim të organeve. "Fatkeqësisht, që nga momenti kur janë bërë publike aktakuzat e para kundër ish-udhëheqësve të UÇK-së dhe ish-udhëheqësve shtetërorë të Kosovës, është bërë e qartë se fokusi i Dhomave të Specializuara ka dalë jashtë mandatit dhe çdo kontrolli institucional, duke u shndërruar në një mekanizëm që i ndjekë vetëm shqiptarët", është thënë në reagimin e PDK-së. PDK-ja kërkon nga Dhomat e Specializuara të Kosovës që ta ndalin këtë fushatë përndjekëse dhe t'i kthehen punës së tyre brenda mandatit dhe fushëveprimit të tyre.



Nga java e ardhshme në shkollat tona do të fillojë Ora e Kodimit

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Nga java e ardhshme në shkollat tona do të fillojë të implementohet iniciativa globale e quajtur Ora e Kodimit. Nxënësit tash e tutje do të përgatiten e nxiten drejt mësim

të kodimit. Ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, ka shkruar në "Facebook" se gjatë javës së Orës së Kodimit, shkollat dhe qendrat partnere do të organizojnë kurse të kodimit, projekte, prezantime

e sesione informuese rreth kodimit, inteligjencës artificiale e shkencave kompjuterike. "Me ftesë të CODE.org po marr pjesë në Konferencën CSEdCon në Las Vegas, në mes të më shumë se 400 pjesëmarrësve të tjerë nga e gjithë

bota. Me partnerë e bashkëpunëtorë ndërkombëtarë do të diskutojmë dhe eksplorojmë bashkëpunimin për edukimin e gjeneratave të ardhshme që të fokusohen dhe të motivohen për t'i studiuar



shkencat kompjuterike", ka shkruar Nagavci.

Investimet direkte në Kosovë deri në muajin gusht arrijnë në 514 milionë euro

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Investimet direkte në Kosovë deri në fund të muajit gusht 2023 shënuan vlerën prej 514 milionë eurove, thuhet në raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) mbi bilancin e pagesave për muajin gusht 2023, duke shtuar se investimet jashtë vendit shënuan vlerën e mbi 145 milionë eurove. Sipas raportit, investimet në letra me vlerë jashtë Kosovës janë rritur

për 322 milionë euro. Derisa investimet në depozita, kredi dhe në kredi tregtare brenda vendit ishin 152 milionë euro, kurse jashtë Kosovës ishin 24 milionë euro.

Sa iu përket asetëve në llogaritë financiare, deri në gusht 2023 kanë arritur në 652.3 milionë euro. Dërgesat nga mërgata për këtë muaj janë rritur për 93.6 milionë euro ose 11.7 për qind më shumë

krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Të ardhurat parësore deri në gusht 2023 kanë shënuar bilanc pozitiv prej 71.5 milionë eurosh.

Në fund, bilanci i pagesave u karakterizua me një deficit të llogarisë rrjedhëse në vlerë prej 220.2 milionë eurosh, i cili tregon një përmirësim prej 41-përqindësh krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.



Rizvanolli u paraqet odave të bizneseve në Paris pakon investive të Kosovës për energji 2023-25



PARIS, 2 NËNTOR - Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, bashkë me ambasadorin e Kosovës në Francë, Mehdi Halimi, janë takuar me përfaqësuesit e Proparcos si dhe me odat e biznesit Lëvizja e Bizneseve Franceze (MEDEF) dhe Business France.

Gjatë takimeve Rizvanolli e ka paraqitur "Pakon investive të Kosovës për energji 2023 - 25", ku

parashihen mundësitë e investimit dhe projekte konkrete për kompanitë e interesuara.

Në këtë pako është paraparë ndërtimi i kapaciteteve prej 950 MW përmes një numri të skemave konkurruese, përfshirë këtu edhe ankandin e parë solar prej 100 MW. "E lumtur ta shoh angazhimin e tyre për të sjellë investime të bizneseve franceze në Kosovë dhe për ta thelluar

bashkëpunimin në energji dhe ekonomi", ka vlerësuar ministrja Rizvanolli.

Përfaqësuesit e Proparcos si dhe Business Francë kanë shprehur gatishmërinë për t'i inkurajuar bizneset e tyre anëtare të investojnë në Kosovë, veçanërisht në sektorë të energjisë.

Kurse kryetari i MEDEF-së, njëherësh oda më e madhe e bizneseve në Francë, Fabrice Le

Sache, ka shprehur kënaqësinë që është takuar me ministren e Ekonomisë së Kosovës, Artane Rizvanolli, gjatë të cilit takim ka vlerësuar punën dhe angazhimin për tërheqje të investimeve dhe i ka ftuar kompanitë franceze të marrin pjesë në skemat konkurruese të parapara nga Kosova, duke filluar me ankandin e parë solar fotovoltaik.

Le Sache ka theksuar se "Kosova

është një nga vendet më dinamike në Ballkan (3.5% rritje në vitin 2022). Popullsia e re e Kosovës po trajtohet gjithnjë e më shumë (zhvillimi i praktikave, rritja e regjistrimit në kurset e inxhinierisë) dhe sistemi tatimor është konkurrues (taksa e korporatës, kostot e punës etj.). Qeveria po udhëheq një program dinamik reformash për ta përmirësuar klimën e biznesit (lufta kundër korrupsionit)".

Më 9 nëntor do të mbahet ankandi i dhjetë i letrave me vlerë për vitin 2023

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se më 9 nëntor do të mbahet ankandi i dhjetë për vitin 2023. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet trevjeçar në shumën prej 25

milionë eurosh.

Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen tre vjet dhe është

tërësisht i liruar nga tatimi. "Për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë, ju lutem kontaktoni ndonjërin nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës", thuhet në njoftim.



Giorgia në kurthin rus



Konflikti në Ukrainë? “Shoh shumë lodhje, më duhet të them të vërtetën nga të gjitha anët. Mund të jemi afër momentit kur të gjithë e kuptojnë se na duhet një rrugëdalje”. Fjalët e kryeministres italiane Giorgia Meloni, e cila ra në grackën e dyshes ruse të specializuar në mashtrimet telefonike, “Vovan dhe Lexus”, alias Vladimir Kuznetsov dhe Aleksej Stolyarov. 37 dhe 36 vjeç respektivisht, të dy dyshohen për lidhje me shërbimet ruse, duke pasur parasysh lehtësinë në talljen e liderëve botërorë dhe të famshëm, nga ish-kancelarja gjermane Angela Merkel te presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan e deri te këngëtari Elton John apo autorja e Harry Potter. J.K. Rowling. Kësaj radhe ata arritën të nxirrmin deklarata nga kryeministria italiane jo vetëm për Kievin, por edhe për fërkimet me BE-në dhe veçanërisht me Francën, për emigracionin dhe Afrikën.

Ishte 18 shtatori, në prag të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Nga ana tjetër e telefonit, sipas një deklarate nga Palazzo Chigi, Meloni besonte se ishte

Moussa Faki, president i Komisionit të Bashkimit Afrikan dhe ish-kryeministër dhe ministër i Çadit, një vend arabo-francez për nga gjuha. Pavarësisht theksit të fortë rus të anglishtes së Aleksej “Lexus” Stolyarov, kryeministria nuk dyshoi. Madje u kënaq me tone bisede miqësore, deri edhe konfidenciale, jashtë çdo rregulli diplomatik: My friend, “miku im”, apo mes “meje dhe teje”. Zyra e Këshilltarit Diplomatik të Kryeministres u detyrua të publikojë një deklaratë që konfirmon vërtetësinë e bisedës dhe “keqardhjen që është gënjyer nga një mashtrues”. Dhe Palazzo Chigi detyrohet të qetësojë: “Mbështetje e plotë për Kievin”.

Lodhja për Ukrainën

Rusi Stolyarov u përpoq disa herë të nxiste kryeministren për krizën ukrainase, duke u ankuar se Afrika nuk mund t’i kërkonte ndihmë BE-së, sepse “të gjitha paratë shkojnë për Ukrainën”. Meloni tha se ishte dakord, duke shtuar se ka “shumë lodhje” sepse konflikti po shkakton kriza të ndryshme, “duke përfshirë emigracionin, inflacionin, rritjen e

çmimeve të energjisë”. “Problemi – tha kryeministria – është të gjendet një zgjidhje e pranueshme për të dyja palët, pa shkelur të drejtën ndërkombëtare. Unë kam disa ide se si ta trajtoj këtë situatë, por jam duke pritur kohën e duhur për t’i hedhur ato në tryezë.” Sa i përket kundëroffensive ukrainase, Meloni pranoi se “ndoshta nuk po shkon siç pritej”.

“Të gjithë e kuptojnë se konflikti mund të vazhdojë për shumë vite nëse ne nuk përpiqemi të gjejmë një rrugëdalje. Problemi është se cila zgjidhje është e pranueshme për të dyja palët, pa hapur konflikte të reja”, shtoi ajo Megjithatë, kryeministria nuk ra në provokime për gjoja nacionalizmin ukrainas. “Është Putini ai që ka një problem nacionalizmi”. Dhe Stepan Bandera, bashkëpunëtori i nazistëve?, e pyeti “Faki”-n fallco. “Nuk e njoh atë. (Ukrainasit) po bëjnë atë që duhet të bëjnë dhe atë që është e drejtë të bëjnë. Dhe ne po mundohemi t’i ndihmojmë”, ka përsëritur Meloni. Pa koment, edhe për hipotezën e përmbushjes së kërkesave ruse për zhbllokimin e marrëveshjes për grurin ukrainas: «Duhet ta diskutojmë. Duhet të

gjejmë një zgjidhje. E kam diskutuar në G20. Nëse lejojmë Rusinë të na shantazhojë, do të përkeqësohet, por nëse nuk gjejmë zgjidhje të tjera, do të bëhet një problem i pamundur (për t’u menaxhuar). Duhet të dalim disi nga kjo”.

Tensionet me BE-në

Kryeministria u ankuar për fluksin e vazhdueshëm të emigrantëve afrikanë. “Që nga fillimi i vitit kanë mbërritur më shumë se 120 mijë njerëz, veçanërisht nga Tunizia. Situata është shumë e vështirë në të gjitha frontet: humanitare, logjistike, e sigurisë. Dhe unë mendoj se kjo rrjedhë mund të rritet për shkak të situatës që po zhvillohet në Afrikë, veçanërisht në Sahel.” Më pas Meloni kishte fjalë të ashpra për incinën e kolegëve të saj të BE-së: «Për një kohë të gjatë Evropa mendonte se mund ta zgjidhte problemin duke e lënë Italinë të qetë. Ajo që ata nuk kuptojnë është se është e pamundur. Përmasat e këtij fenomeni prekin, për mendimin tim, jo vetëm BE-në, por edhe OKB-në. Por problemi është se të

tjerëve nuk u intereson. Ata nuk u përgjigjen në telefon kur i mora. Dhe të gjithë janë dakord që Italia duhet ta zgjidhë e vetme këtë problem. Është një pozicion shumë idiot”. Dhe më pas ajo përsëriti: “BE thotë se e kupton. Por kur i kërkon të ndajnë fonde, të ndihmojnë, bëhet më e vështirë, duhet të them të vërtetën”.

Irritimi me Francën

Ishte Meloni ajo që u përpoq të nxirrte një opinion “ta themi mes nesh” nga gjoja Moussa Faki duke e pyetur nëse ai mendonte se grushti i shtetit në Niger kishte qenë në të vërtetë një lëvizje kundër Francës. Parisi, thotë kryeministria pa e fshehur acarimin e saj, “po shtyn pak për një lloj ndërhyrjeje, por po përpiqem të kuptoj se si mund të mbështesim përpjekjet diplomatike. Duhet të jemi të kujdesshëm”. Dhe më pas ajo shpjegoi se francezët “kanë prioritete të ndryshme në Niger”, duke pasur parasysh se vendi është i pasur me uranium dhe minerale të tjera. “Pikëpamja e tyre është e ndryshme nga e imja”. / la repubblica – bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kryeministri Kurti priti në takim fitueset e medaljes së bronzë në Kampionatin Botëror

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, bashkë me zëvendësministren e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Daulina Osmani, kanë pritur në takim ekipin e Kosovës në karate në konkurrencën e vajzave, i përbërë nga Fortesa Orana, Vlera Qerimi, Hatixhe Zejnullahu dhe Albulena Gervalla, i cili ka fituar medalje të bronzë në Kampionatin Botëror të Karatesë që u mbajt nga 24-29 tetor në Budapest të Hungarisë. "Me këtë rast, kryeministri Kurti i

uroi për suksesin e arritur në Kampionatin Botëror, në të njëjtën kohë u dëshiroi atyre suksese të mëtejme duke i siguruar mbështetje institucionale në mënyrë që të vazhdojnë me rezultate e suksese të tjera", shkruan zyra e kryeministrit Kurti. Sportistet falënderuan kryeministrin Kurti për pritjen dhe mbështetjen. Gjatë bashkëbisedimit ato ndanë me të përvojat e tyre nga pjesëmarrja në kampionat dhe rrugëtimin e tyre në karrierën profesionale. Ky

sukses vlerësohet historik pasi që është fituar për herë të parë në konkurrencën e femrave dhe në nivel ekipor në karate. Kosova në këtë kampionat regjistroi katër fitore duke mposhtur Anglinë, Zvicrën, Francën dhe Kazakistanin dhe vetëm një humbje, nga Japonia, e cila më pas arriti deri në finale. Vlen të theksohet se në këto pesë meçe të Kosovës karateistja Fortesa Orana ka qenë e pamposhtur duke shënuar pesë fitore. Në këtë garë morën pjesë gjithsej 55 shtete nga e gjithë bota.



Llapi ndalet nga Fushë-Kosova, Liria barazoi me Dukagjinin

Llapi i Tahir Batatinës ka bërë edhe një tjetër lëshim në garë për kreun e tabelës, pasi nuk ka mundur të marrë më shumë se një pikë në përballjen me skuadrën e Fushës-Kosovës. Edhe ndeshja tjetër në mes të Lirisë dhe Dukagjinit ka përfunduar pa fitues 2-2

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 2 nëntor - Janë zhvilluar dy ndeshjet e fundit për javën e 12-të në Superligën e Kosovës në futboll. Skuadra e Llapit është ndalur në barazim nga Fushë-Kosova (1-1) në ndeshjen që është zhvilluar të enjten në stadiumin "Zahir Pajaziti". Skuadra e Tahir Batatinës edhe një herë ka gabuar në garë për kreun e tabelës, pasi si vendëse, ndaj një skuadre dukshëm më të dobët nga cilësia, nuk arriti ta marrë maksimumin e pikëve dhe

tash ka tetë pikë pas skuadrës kryesuese. Në minutën e 16 Urim Statovci e kaloi skuadrën mysafire në epërsi 0-1. Llapi dominoi më pas, por pa arritur ta gjejë golin e barazimit. Në minutën e 61-të Ahmet Januzi barazoi shifrat në 1-1, derisa në fund të ndeshjes Llapi kishte një mundësi të artë për të kaluar në epërsi, por nga pika e bardhë nuk ishte i saktë Muhamet Hyseni. Pas këtij barazimi, Llapi vazhdon të jetë në vendin e tretë me 21 pikë, ndërsa Fushë-Kosova është në vendin e fundit me 7 pikë. Në ndeshjen tjetër në mes të Lirisë dhe



Dukagjinit rezultati final ishte 2-2. Në minutën e 73-të, Moria kaloi mysafirët nga Klina në epërsi 0-1. Tre minuta para fundit të ndeshjes, Tijueza barazoi rezultatin në 1-1, derisa në minutën e parë shtesë Stafa kaloi vendasit në epërsi 2-1. Kur të gjithë priten fitoren e vendësve, në skenë doli Elezaj që realizoi për 2-2 në minutën e tetë

shtesë. Pas kësaj ndeshje, Dukagjini është në vendin e shtatë me 13 pikë, kurse Liria e dhjeta me tetë pikë. Të mërkurën janë zhvilluar tri ndeshje të tjera të kësaj xhijroje.

Skuadra kampione në fuqi, Ballkani, e mposhti Dritën (1-0). Golin e vetëm në ndeshje e realizoi mbrojtësi Lumbardh Dellova në minutën e 37, ndërsa Malisheva e ka mposhtur Prishtinën me rezultat 1-0. Golin e vetëm në këtë ndeshje e realizoi katër minuta pa përfunduar koha e rregullt, Ilir Mustafa. Edhe në ndeshjen tjetër fitues ishin vendasit, pra Gjilani e mposhti skuadrën e Feronikelit 74

SUPERLIGA		
Llapi - Fushë-Kosova		1-1
Liria - Dukagjini		2-2
Gjilani - Feronikeli '74		2-1
Malisheva - Prishtina		1-0
Ballkani - Drita		1-0

Tabela		
		Pikë
1. Ballkani	11	29
2. Drita	11	22
3. Llapi	12	20
4. Malisheva	12	16
5. Prishtina	12	16
6. Gjilani	12	14
7. Dukagjini	12	14
8. Feronikeli	12	11
9. Liria	12	8
10. Fushë Kosova	11	6

me rezultat 2-1. Ismajli e Milev realizuan për vendasit, kurse për mysafirët shënoi Shillova.

Ujkani emërohet zëvendësdrejtor i Përfaqësueses së Kosovës

PRISHTINË, 2 NËNTOR - 1 nëntori ishte dita kur portieri i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Samir Ujkani, e la futbollin aktiv, duke e mbyllur karrierën në moshën 35-vjeçare. Gjatë ditës së djeshme, përmes një postimi në rrjete sociale, Ujkani njoftoi lidhur me vendimin që kishte marrë, po ashtu shprehu emocionet dhe përjetimet e tij gjatë gjithë karrierës, duke falënderuar klubet në të cilat ka



luajtur dhe të gjithë bashkëpunëtorët e tij. Por në fund

të letërës përshëndetëse ai shkroi: "Çdo fund sjell një fillim të ri dhe fillimi im i ri, po nis tani". Dhe Samir Ujkani nuk kishte pse të presë gjatë për "fillimin e ri". Pas karrierës së suksesshme në skuadra të ndryshme në Evropë, po ashtu përvojës dhe suksesit në Përfaqësuesen e Kosovës, Ujkani është ftuar t'i bashkohet Përfaqësues A, por me përgjegjësi të reja. Në fakt, presidenti i

Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, sot priti në zyrën e tij Ujkanin dhe e falënderoi për kontributin e jashtëzakonshëm në fanellën dardane, njëkohësisht për ta mirëpritur në postin e ri si zëvendësdrejtor në përfaqësuese. I pari i FFK-së i uroj shumë suksese në detyrën e re dhe shprehu mirënjohjen e tij për kontributin e deritashëm. Më tutje, presidenti Ademi kërkoi nga ish-portieri i

Kosovës angazhim dhe përkushtim maksimal edhe në postin e ri. Nga ana tjetër, Ujkani u shpreh i lumtur për detyrën e re që presidenti Ademi dhe FFK-ja i besuan. Ai falënderoi Ademin dhe pohoi se do ta japë maksimumin në këtë pozitë dhe se do të punojë me shumë dashuri dhe përkushtim për përfaqësuesen, ashtu siç kishte bërë deri dje në fushën e gjelbër.

Penza - Bashkimi, derbi i javës në Superligën e Femrave

Pejë, 2 nëntor - Java e pestë në Superligën e Femrave sfidon rivalët e vjetër. Penza dhe Bashkimi është kryendeshja e kësaj jave. Penza është nikoqire e Bashkimit dhe ndeshja do të zhvillohet të

premtën me fillim nga ora 17:00 në palestrën "Karagaqi". Të premtën në orarin e Superligës të Femrave zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera. Në Pejë zhvillohet edhe ndeshja Peja 03 - Trepça me

fillim nga ora 19:00, kurse ndeshja Prishtina United Basketball është ndeshja e fundit e cila zhvillohet në këtë xhiro. Ndeshja do të zhvillohet në Pallatin e Rinisë nga ora 20:30. Prishtina është skuadra

e vetme me bilanc 4 ndeshje 4 fitore, Bashkimi ka tri fitore në katër ndeshje. Trepça dhe Peja 03 kanë nga dy fitore, Penza një fitore, kurse United Basketball nuk ka shënuar ende asnjë fitore.



Papa Françesku preferon Pelen para Messit dhe Maradonës: Ishte shumë humanitar

Romë, 2 nëntor - Debatet kanë qenë të ndezura përherë se kush mes Pele, Messi, Maradona e Cristiano Ronaldo është më i miri i historisë së futbollit, ku të shumtë janë ata që janë tifozë të "flaktë" të

dysjes argentinase. Së fundmi, mendimin e tij mbi këtë temë e ka dhënë edhe Papa Françesku, i cili në një intervistë të dhënë për mediet italiane u pyet pikërisht për këtë çështje, teksa theksoi se i preferuari i tij është

legjenda e Brazilit, Pele. "Midis Maradonas dhe Messit, kë preferoj? Do të them një të tretën, Pele. Maradona ishte i mrekullueshëm si lojtar, por si njeri ai dështoi, ai rëshqiti me atyre që e lavdëruan dhe nuk e

ndihmuan, djaloshi i gjorë. Messi është shumë korrekt, zotëri, por unë preferoj Pelen, një njeri me zemër, ai ishte shumë humanitar. Megjithatë atë të tre mbeten të mëdhenj", ka thënë Papa Françesku.



Lakersat fitojnë derbin me Clippersat pas 11 humbjesh radhazi

LOS ANXHELOS, 2 NËNTOR - Pas 11 ndeshjes radhazi të humbura në derbin e Los Anxhelosit ndaj Clippersve, skuadra e Lakersave fitoi me rezultat 130-125. Një ndeshje që u vendos në kohën shtesë, me Lakersat që rikuperuan një disavantazh prej 19 pikësh në pjesën e parë. Leonardo dhe George realizuan 63 pikë së bashku, por që s'mjaftuan për Clippersat. Për Lakersat shkëlqeu LeBron Jamesi me 35 pikë e 12 rebounde,



mbështetur edhe nga Davisi e Russellit, që realizuan nga 27 pikë secili. Milwaukee pësoi një humbje të turpshme në Kanada, ku u mund 130-111 nga Toronto. Për vendasit u dallua Siakami me 26 pikë. Zhgënjën edhe Miami, që në fushën e tij u mund me rezultat 109-105 nga Brooklyni (50 pikë erdhën nga lojtarët e stolit). Bostoni dhe Dallasi janë dy skuadra e vetme që s'njohin humbje deri më tani në NBA. Bostoni mundi thellë 155-104

Indianan (u dallua me Tatum 30 pikë e 12 rebounde), ndërsa Dallasi fitoi me rezultat 114-105 ndaj Chicagos (u dallua Williamsi me 25 pikë). Skuadra e Golden States, falë 21 pikëve të Curryt, mundi në sekondat e fundit 102-101 Sacramenton. Bien edhe kampionët e Denverit, që pësojnë humbjen e parë sezonale. Denveri u mund me rezultat 110-89 në fushën e Minnesotas (Edwards 24 pikë për vendasit).

REZULTATET

Detroit - Portland	101-110
Toronto - Milwaukee	130-111
Atlanta - Washington	130-121
Boston - Indiana	155-104
Miami - Brooklyn	105-109
New York - Cleveland	89-95
Oklahoma - New Orleans	106-110
Houston - Charlotte	128-119
Minnesota - Denver	110-89
Dallas - Chicago	114-105
Utah Jazz - Memphis	133-109
Golden St. - Sacramento	102-101

Mercedesi, sfidë Ferrarit në Brazil: Nuk do t'jua falim atë pozicion, për ne ka rëndësi

STUTTGART, 2 NËNTOR - Te Mercedes përgatiten për një betejë të ashpër me Ferrarin në tri garat e mbetura, teksa synojnë ta mbrojnë vendin e dytë në renditjen për konstruktorë. Në garën e fundit në Meksikë, makina gjermane ruajti avantazhin prej 22 pikësh ndaj "kokëkuqes", teksa të dyja skuadrat dolën nga ajo garë me nga 27 pikë secila.

Toto Wolff, drejtori sportiv i Mercedesit, në prag të garës së Brazilit, këtë fundjavë në pistën e Interlagos, ka thënë: "U larguam nga Meksika me një vend të dytë të Hamiltonit, që na dha mundësi ta ruajmë avantazhin prej 22 pikësh ndaj Ferrarit. Bëhet fjalë për një sfidë të rëndësishme për ne dhe duam ta fitojmë". "Tani përgatitemi për një garë të vështirë,



por këtu kemi kujtime të mira, pasi vjet arritëm fitoren e vetme me Russellin. Shpresoj që dy pilotët tanë ta japin maksimumin edhe në këtë pistë. Do të jetë një fundjavë e gjatë, pasi kemi edhe garën sprint, ndaj duhet të maksimizojmë çdo mundësi që na jepet", ka shtuar Wolff. "E dimë

që kemi bërë hapa përpara në garat e fundit, ndaj është e rëndësishme ta ruajmë këtë ritëm. Tifozët janë shumë të apasionuar këtu pas Formulës 1, ndaj duam t'u dhurojmë entuziazëm. Jam i sigurt se do të jetë një spektakël si në pistë ashtu dhe jashtë saj", ka deklaruar Toto Wolff.

SHKURT

Trajneri i Lecces: Medon Berisha ishte, ndoshta, më i miri në fushë

Ylber Ramadani dhe Medon Berisha spikatën te skuadra e Lecces mbrëmjen e djeshme, edhe pse skuadra e tyre u mund 2-4 nga Parma. Pikërisht për talentin e "Shpresave", Medon Berisha, foli disa fjalë edhe tekniku i skuadrës së Lecces, Roberto D'Aversa, i cili, pas ndeshjes, nuk kurseu "elozhet" për 20-vjeçarin. "Ai ka treguar se nuk është si lojtarët e tjerë të rinj që vijnë nga Primavera. Kam pasur përgjigje pozitive edhe nga lojtarët e tjerë. Nëse më duhet të analizoj më të mirët në fushë, ai ishte, ndoshta, më i miri", ka thënë D'Aversa.

Tuchel: Jemi të zhgënjyer nga eliminimi prej Kupës

Bayern Muncheni është eliminuar nga Kupa e Gjermanisë, pasi humbi përballjen me skuadrën Saarbrücken (2-1). Gjiganti gjerman edhe një vit më parë u eliminua në fazën çerekfinale. Trajneri Thmoas Tuchel ka thënë se eliminimi është i hidhur dhe se të gjithë në klub janë të zhgënjyer. "Është një ndjesi e çuditshme, e hidhur pa diskutim. Mund të ketë 100 shpjegime për këtë disfatë, ose vetëm një, por jemi krejtësisht të zhgënjyer. Urime kundërshtarëve!", u shpreh Tuchel.

Messi zbulon golin e tij të pëlqyer

Lionel Messi, pasi fitoi Kupën e Botës në Katar dhjetorin e kaluar, iu dha dhe "Topi i Artë" i vitit 2023 për të tetën radhë. Faqja në "Instagram" e "Topit të Artë" ngarkoi një video me deklaratë të superyllit argentinasi, ku në një njërën prej tyre ai veçoi golin e tij të pëlqyer nga 821 golat e karrierës së tij. Më 27 prill 2011 Barcelona mundi Real Madridin 2-0 në ndeshjen e parë gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve, me argentinasin që i shënoi të dy golat (76' - 87'). "Gjithmonë them se golat specialë janë ata që kam shënuar në finalen e Ligës së Kampionëve, ata që kam shënuar në finalen e Kupës së Botës. Nuk e di, por goli që më kujtohet gjithmonë është ai kundër Real Madridit, kur e mundëm 2-0 në 'Bernabeu' në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. Mendoj se golat më të paharrueshëm janë gjithmonë më të rëndësishmit, por tani për tani do t'i përmbahem njerit prej tyre", ka thënë Messi.

Davies, synim i Real Madridit në janar

Mbrojtësi Alphonso Davies mund të largohet nga Bayern Muncheni në afatin kalimtar të janarit. Sipas medieve spanjolle, Real Madridi është gati të hidhet në sulm për t'i siguruar shërbimet e kanadezit. Madrilënët janë të gatshëm t'u paguajnë "bavarezëve" 50 milionë euro për ta bindur që ta shesë mbrojtësin disa muaj para skadimit të kontratës. Një ofertë tunduese kjo për "rekordmenët" e Gjermanisë duke parë që Davies nuk dëshiron ta rinovojë kontratën dhe se në verë do ta ketë mundësinë të largohet me parametra zero.

Futbollisti 21-vjeçar qëllohet për vdekje me 10 plumba në Brazil

Futbollisti i ri nga Brazili, Felipe Diogo, është vrarë me dhjetë plumba, raportojnë mediet e huaja. 21-vjeçari është vrarë në Sao Paulo Ribeirao Preto, provincën ku lindi dhe u rrit.


Felipe Diogo u dërgua në spital, por mjekët mundën vetëm ta konstatonin vdekjen e tij. Nuk dihen motivet e këtij krimi të rëndë, ndërsa mediet nga Brazili shkruajnë se atentati është kryer

nga "sulmues të armatosur misteriozë". Ata e dinin saktësisht rrugën e Diogos dhe e prisnin në rrugën që çonte në shtëpinë e tij. Klubi Sao Bernardo, i cili garon në Serinë C

dhe për të cilin ka luajtur Felipe Diogo, i ka dhënë lamtumirën e fundit futbollistit të ri me një mesazh prekës. "Klubi i futbollit Sao Bernardo mori me keqardhje të madhe lajmin për

vdekjen e sportistit tonë Felipe Diogo Bernardes Ferreira. Zoti ngushëlloftë zemrat e familjes së tij në këtë moment pikëllimi të thellë!", shkruhet në faqen e "Instagram"-it të klubit brazilian.

REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO
ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA
№.№.№. 5159/23 02 OCT 2023



ОДЕЉЕЊЕ ЗА ОБРАЗОВАЊЕ И КУЛТУРУ

На основу члана 80, 81, 82. Закона о Јавним службеницима Вг.08/3-197, Закона о раду РК бр.03 / 3-212, Закона о предуниверзитетском образовању РК бр. 04/3 -032, на основу Административног упутства (МОНТ) бр.05/2021 о нормативу професионалног кадра општег образовања, на основу Административног упутства (МОНТ) бр.05/2015 о нормативу за наставнике професионалног образовања и на основу Административног упутства 07/2017 о регулсању процедура конкурса у јавним сектору Одељење за образовање и културу, објављује:

КОНКУРС

за допуцу слободних радних места

Институција	Позиција	Наставни часови	Коефицијент	Период уговора	Назив надзорног	Број позиција
ОШ „Свети Сава“ Сушица	Наставник разредне наставе	20	E19-5.6	На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад)	Директор Одељења за образовање	1
ОШ „Вук Караџић“ Лепина	Наставник ликовне културе	20	E19-5.6	На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад)	Директор Одељења за образовање	1
ОШ „Угљаре“ Угљаре	Наставник историје	20	E19-5.6	На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад)	Директор Одељења за образовање	1
	Укупно					3

Институција	Позиција	Наставни часови	Коефицијент	Период уговора	Назив надзорног	Број позиција
-Електротехничка школа -Сушица	Професор физичког вапитања	20	E17-5.8	На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад)	Директор Одељења за образовање	2
-Гимназија-Лапље Село						
	Укупно					2

Главни задаци :

- Да реализује наставни план и програм за дотично радно место, на основу закона и подзаконским актима које регулишу релевантне области за наведено радно место;
- Да припреми редовни годишњи, месечни и дневни план, у складу са потребама за усклађивање наставе, способности и индивидуалних талената сваког ученика;
- Да има знања о ширем репертоару наставних стилова и да буде у стању да их примењује тако да најбоље одговарају ситуацији у учионици;
- Да планира, руководи и надгледа наставу и понашање сваког ученика;
- Да спроводи нове методологије наставе и процене у складу са упутствима;
- Да учествује у организационом раду школе;
- Да активно учествује у припремању програма и догађаја у школи;
- Да покаже поштовање, колегијалност и не-дискриминационо понашање према сарадницима са којима ради;
- Да поштује директан ауторитет службеника, и да обавља обавезе које му могу одредити. Радни задаци треба да буду у складу са важећим законодавством.
- Да одржи час разредног и дневног дежурства;
- Запослени је у обавези да поштује кодекс облачења и понашања, који је одређен интерном уредбом школе и другим законским и подзаконским актима;

Услови и квалификације:

Поред општих услова за пријем према члану 9. Закона о јавним службеницима, услови и квалификације које кандидат мора да поседује су :

- Едукативни факултет (Мастер 300 ECTS),
- Четворогодишњи систем,
- Bachelor – (четворогодишњи 240 ECTS)

Кандидати приликом аплицирања подносе следећу документацију:

- Формулар за пријаву (апликација);
- Факултетска диплома - (оверена копија);
- Лична карта (копија)
- Доказ да није осуђиван за кривична дела
- Доказ о радном искуству (уколико га поседује)

Конкурс (рок аплицирања) је отворен 15 дана од 03.11.2023- 17.11.2023. године

Формулар за пријаву се могу преузети и поднети сваког радног дана у писарници општине Грачаница у периоду од 08:00 до 16:00 часова.


На разговор ће бити позвани само кандидати који испуњавају критеријуме и уђу у ужи избор.

Пријаве мушкараца и жена из свих заједница су добродошле.

Пријаве пределе након истека рока неће бити прихваћене, а неисправне пријаве ће бити одбијене.

Директор
Бранкица Нићић

REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO
ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA
№.№.№. 5159/23 02 OCT 2023



DREJTORIA PËR ARSIM DHE KULTURË

Нë базë тë ненит 80, 81 dhe 82 тë Лигит пëр Зyrтарët Publik nr.08/L-197, Лигит тë Punës нë RK-së nr.03/L-212, Лигит пëр Арсимин Parauniversitar нë RK-së nr.04/L-032 dhe нë базë тë Udhëzimit administrativ (MASHT) nr.05/2021 пëр нормативн мби kuadrin profesional тë арсмит тë пëргjithshëm, Udhëzimit administrativ (MASHT) nr.05/2015 пëр нормативн пëр мësimdhënësit e арсмит profesional dhe нë базë тë Udhëzimit administrativ nr.07/2017 пëр rregullimin e procedurave тë konkursit нë sektorin publik, Drejtoria пëр Арсим dhe Kulturë shpall кëtë:

KONKURS

пëр plotësimin e vendeve тë lira тë punës

Institucioni	Pozita	Orë mësimi	Koeficienti	Periudha e kontratës	Emri i eprorit	Numri i pozitave
ShF „Sveti Sava“ Sushicë	Mësimdhënës i mësimin klasor	20	E19-5.6	Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë)	Drejtor i Drejtorisë së Arsimit	1
ShF „Vuk Karadžić“ Lepinë	Mësimdhënës i kulturës së artit	20	E19-5.6	Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë)	Drejtor i Drejtorisë së Arsimit	1
ShF „Ugljarë“ Ugljar	Mësimdhënës i historisë	20	E19-5.6	Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë)	Drejtor i Drejtorisë së Arsimit	1
	Gjithsej					3

Institucioni	Pozita	Orë mësimi	Koeficienti	Periudha e kontratës	Emri i eprorit	Numri i pozitave
-Shkolla Elektroteknike Sushicë	Profesor i edukatës fizike	20	E17-5.8	Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë)	Drejtor i Drejtorisë së Arsimit	2
-Gjimnazi Llapllasellë						
	Gjithsej					2

Detyrat kryesore:

- Të realizojë plan-programin mësimor për vendin përkatës të punës, duke u bazuar në ligjin dhe aktet nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin përkatës të punës;
- Të përgatisë me rregull planin mësimor vjetor, mujor dhe ditor, në përputhje me korrikulën, e në pajtim me kërkesat për përshtatjen e mësimdhënies, aftësive dhe prirjeve individuale të çdo nxënësi;
- Të ketë njohuri për një repertor të gjerë të stileve të mësimdhënies dhe të jetë në gjendje t'i aplikojë ato që më së miri i përgjigjet situatës në klasë;
- Të planifikojë, të udhëheqë dhe të vëzhgojë nxënëin dhe sjelljen e çdo nxënësi;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimin në përputhje me udhëzimet kurrikulare;
- Të marrë pjesë në punën organizative të shkollës;
- Të marrë pjesë aktive në përgatitjen e programeve dhe ngjarjeve në shkollë;
- Të tregojë respekt, sjellje kolegiale dhe jodiskriminuese ndaj bashkëpunëtorëve me të cilët punon;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'i përcaktohen. Detyrat e punës duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Të mbajë orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore;
- I punësuar është i obliguar të respektojë kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuara me rregulloren e brendshme të shkollës dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore.

Kushtet dhe kualifikimi: Staf mësimor

Përveç kushteve të përgjithshme për pranim sipas nenit 9 të Ligjit për Zyrtarët Publik, kushtet dhe kualifikimet që kandidati duhet të zotërojë janë:

- Fakulteti i Edukimit (Master 300 ECTS),
- Sistemi katërvjeçar,
- Bachelor – (katërvjeçar 240 ECTS).

Gjatë aplikimit, kandidatët paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- Formulari i aplikimit (aplikacion);
- Diploma e fakultetit - (kopje e vërtetuar);
- Letërnjoftimi (kopje);
- Dëshmia se nuk ka qenë i dënuar për vepra penale;
- Dëshmia për përvojën e punës (nëse e posedon)

Konkursi (afati i aplikimit) është i hapur 15 ditë nga 03.11.2023 - 17.11.2023

Formularët e aplikimit mund të shkarkohen dhe dorëzohen çdo ditë pune në Shkrimoren e Komunës së Graçanicës nga ora 8:00 deri në orën 16:00.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe kanë hyrë në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë.

Aplikacionet nga burrat dhe gratë nga të gjitha komunitetet janë të mirëseardhura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk do të pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta do të refuzohen.

Директор
Бранкица Нићић



MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.
Rruga e Liqenit p.n. – 40000 Mitrovicë

Data: 03.11.23 Nr.: 1559

Duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimin Administrativ Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik Nr.07/2017, Kompania Rajonale Ujësllësi “Mitrovica” Sh.A. në Mitrovicë, shpallë:

K O N K U R S

(Për plotësimin e vendit të lirë të punës, punë provuese gjashtë (6) muaj, me mundësi vazhdimi)

IV. Emërtimi i vendit të punës: Ujëinstalues

Përgaditja profesionale: Shkolla e Mesme

Përvoja e punës: Së paku 1 vjet.

Numri i kryesve: (2)

Vendi : KRUM – Njësia Vushtrri

Koeficienti i pagës: 452.19 Euro

Kushtet të veçanta: Të kenë kualifikimin e lartë ose të mesëm për Ujëinstalues.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës,
- Kryen të gjitha llojet e kyçjeve në rrjetin e ujësllësi si dhe montimin e të gjitha profileve të ujëmatësive,
- Bënë përgatitjen e materialit të nevojshëm dhe mjetet me të cilat është ngarkuar,
- Punon në montimin e gypave të çdo lloji,
- Me materialin e ngarkuar në teren është i obliguar si gjatë punës po ashtu edhe pas punës të vendos në vendet e caktuara,
- Është i obliguar që në çdo kohë të intervenojnë në rast të prishjeve në rrjetin e ujit dhe për këtë të informoj personin përgjegjës në afatin sa ma të shkurtër,
- Organizon punët në vendin e ngjarjes dhe është përgjegjës për të gjitha punët dhe detyrat e dhëna,
- Kryen edhe punë tjera që i përkasin këtij sektori sipas urdhrat Udhëheqësit,
- Për punën që kryen i përgjigjet Shefit të Rrjetit të Ujit.

Dokumentet e kërkuara:

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe së bashku me këtë aplikacion të bashkangjesin edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Letër motivimi,
- Diploma e Universitare (kopja e noterizuar, kurse diploma nga universiteti jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmi nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmi mbi eksperiencën e punës (Trusti),
- Kopja e letërnjoftimit.

Mënyra e aplikimit:

- Aplikacionet mund të merren ueb-faqen e Kompanisë KRU “Mitrovica” Sh.A. në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset/>, si dhe fizikisht në zyrën për Burime Njerëzore, dhe të dorëzohen në të njëjtën zyrë së bashku me dokumentacionin përcjellës në formë fizike.
- Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit nga data 03.11.2023 deri me datën 17.11.2023.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.
- Dokumentet e pranuar të aplikantëve në fotokopje nuk kthehen.
- Kompania Rajonale Ujësllësi “Mitrovica” Sh.A. në Mitrovicë inkurajon kandidatet femra, kandidatët nga grupet minoritare si dhe personat me aftësi të kufizuara të aplikojnë.

VËREJTJE: Kandidatët të cilët paraqesin aplikacionin e pa-plotësuar, apo nuk i bashkëngjisin dokumentet e kërkuara si në konkurs, aplikimet e tyre do të refuzohen dhe të njëjtit nuk do të i nënshtrohen procedurës së rekrutimit.



MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.
Rruga e Liqenit p.n. – 40000 Mitrovicë

Data: 03.11.23 Nr.: 1559

U skladu sa članom 8. Zakona o radu br. 03/L-212 i Administrativnog uputstva za regulisanje postupaka u vezi sa oglasom za radna mesta u javnom sektoru br. 07/2017, Regionalno vodovodno preduzeće „Mitrovica“ d.d. u Mitrovici, je objavila ovaj:

OGLAS ZA RADNO MESTO

(Za popunjavanje slobodnih radnih mesta šest (6) meseci probni rad sa mogućnošću produženja)

IV. Naziv radnog mesta: Vodoinstalater

Profesionalna kvalifikacija: Srednja škola

Radno iskustvo: Najmanje 1 godina.

Broj pozicija: (2)

Koeficijent plate: 452.19 Euro

Posebni uslovi: Kandidat mora da ima višu ili srednju kvalifikaciju za vodoinstalatera.

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Sposoban da obavlja radne obaveze sa punim radnim vremenom i bez ograničenja,
- Vršiti sve vrste priključaka na vodovodnu mrežu kao i montažu svih vodomernih profila,
- Priprema potrebni materijal i alat koja su mu dodeljena,
- Radi na montaži cevi bilo koje vrste,
- Sa dodeljenim materijalom na teren dužan je i za vreme rada i posle rada da ga postavi na predviđena mesta,
- U svakom trenutku interveniše u slučaju kvarova na vodovodnoj mreži i da u najkraćem roku obaveste odgovorno lice.
- Organizuje rad na mestu događaja i odgovoran je za sve dodeljene poslove i zadatke,
- Obavlja i druge poslove iz ovog sektora po nalogu rukovodioca,
- Za poslove koje obavlja odgovoran je načelniku Vodovodne mreže.

Potrebna dokumentacija:

Zainteresovani kandidati moraju popuniti prijavu Preduzeća i uz prijavu priložiti sledeću dokumentaciju:

- CV (Biografija),
- Motivaciono pismo,
- Univerzitetska Diploma (overena kopija, dok diploma sa ustanove u inostranstvu mora biti nostrifikovana),
- Dokaz nadležnog suda da nije pod istragom, ne stariji od 6 meseci,
- Dokaz o stručnom usavršavanju,
- Dokaz o radnom iskustvu (Trusti),
- Kopija lične karte.

Način prijave:

- Prijave se mogu dobiti na sajtu Preduzeća RVP „Mitrovica“ d.d. na adresi: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset/>, kao i fizički u Službi za ljudske resurse, i dostaviti istoj kancelariji zajedno sa pratećom dokumentacijom u štampanom obliku.
- Konkurs će biti otvoren 15 dana od dana objavljivanja od 03.11.2023 do 17.11.2023.
- Prijave dostavljene nakon isteka roka se ne prihvataju.
- Prihvaćena dokumenta podnosiocima prijava u fotokopijama se ne vraćaju.
- Regionalno vodovodno preduzeće „Mitrovica“ d.d. u Mitrovici podstiče kandidatkinje, kandidate iz manjinskih grupa i osobe sa invaliditetom da se prijave.

NAPOMENA: Kandidatima koji podnesu nepotpunu prijavu, ili ne prilože traženu dokumentaciju kao u oglasu za konkurs, prijave će biti odbijene i neće biti predmet postupka prijema.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shpresa Abdullah Spahija shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit Ekonomik të UP-së.

- Lavdrim Murati shpall të pavlefshme dokumentet e nostrifikuara të shkollës së mesme Teknike "Presheva" në Preshevë.

- Nashide Kryeziu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Valmie Rogomaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Leonora Ternava shpall të pavlefshme diplomën e Bachelorit të Kolegjit AAB- Prishtinë.

- Bajram Morina shpall te pavlefshme dëftesat e kl I, II SHFMU "Leke Dukagjini" Prizren.


- Murat Duraj shpall te pavlefshme dëftesat e kl X, XI, XII, XIII dhe diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejite

RESTAURANT

SWISS
TAVERNATel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

